



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 971/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale “Ujësjiellësi Prishtina”, SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit A.SH. Kozmetika EBC, me seli në Prishtinë, rruga “Garibaldi”, H-5 27, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1312/22 të datës 31.05.2023, me datë 09.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale “Ujësjiellësi Prishtina”, SH.A., me seli në Prishtinë, dhe vendimi Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1312/22 të datës 31.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1312/22 të datës 31.05.2023, ka vendosur si në vijim: **APROVOHET** pjesërisht prapësimi i debitorit A.SH. Kozmetika EBC, dhe **ANULOHET** pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.109/2021, i datës 02.02.2021, i Përmbartuesit Privat Arsim I. Bajraktari, për pjesën e detyrimit në shumën prej 769.64 € (shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e katër cent). **REFUZOHET** pjesërisht prapësimi i debitorit A.SH. Kozmetika EBC dhe **MBETET NË FUQI** pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.109/2021 të datës 02.02.2021, të Përmbartuesit Privat Arsim I. Bajraktari, sa i përket shumës prej 76.64 € (shtatëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e katër cent) dhe **PËRFUNDOHET** pjesërisht procedura përmbartimore e

kreditorit “Kompania Rajonale e Mbeturinave “Ujësjellësi Prishtina”, SH.A., ndaj debitorit A.SH. Kozmetika EBC, sipas urdhrin përmbarrimor P.nr.109/2021 të datës 02.02.2021, për shumën prej 769.64 € (shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e katër cent).

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet apo ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Cështje Ekonomike, KPPP.nr.1312/22 të datës 31.05.2023.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë .

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale “Ujësjellësi Prishtina”, SH.A., ka caktuar urdhrin përmbarrimor P.nr.109/2021 të datës 02.02.2021, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.96529, nga data 01.01.2013 deri me datë 27.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin A.SH. Kozmetika EBC, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 846.28 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, në të kundërtën përmbarrimi të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirrollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit në TEB Bank nr....., ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përmbarrimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit me arsyetimin se kreditori nuk ka bazë për paraqitjen e propozimit për përmbarrim, sepse në asnjë moment nuk ka mundur të paraqesë se në cilën faturë saktë është krijuar borxhi në vlerë prej 846.28 euro. Tutje ka shtuar se borxhi është parashkruar që nga viti 2013, ndërsa faturat

nga viti 2013 deri në vitin 2021 janë të paguara ashtu siç dëshmohet edhe lista e pagesave të dorëzuara nga vetë kreditori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapsim i debitorit dhe të refuzohet Urdhri Përmbartimor P.nr. 109/21, i datës 02.02.2021, i lëshuar nga përmbartuesi privat Arsim I. Bajraktari.

Kreditore nuk ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Cështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1312/22 të datës 31.05.2023 .

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.96529, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shumata e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata në shkallë të parë ka vlerësuar se në rastin konkret Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr.96529, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është e dorëzuar në kopje të verifikuar si dhe duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të ekstraktit nga librat afarist për faturat e përfshira në ekstrakt dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar sepse kërkesa e kreditorit për faturat nga data nga data 31.12.2013 deri me datën 28.08.2018, është parashkruar, andaj me të drejtë pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe për shumën prej 769.64 €, e anuloi urdhrin për përmbartim P.nr.109/2021 të datës 02.02.2021, të Përmbartuesit Privat Arsim I Bajraktari, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata në shkallë të parë drejtë ka vendosur sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore 28.02.2018 gjerë me datë 31.01.2021, dhe nuk ka

vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 28.02.2018 deri më datë 31.01.2021, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 02.02.2021, ka ushtruar propozim për përmbarrim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Dhoma e Shkallës së Dytë, njëjtë sikurse edhe Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën prej 76.64 €, pasi që se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar. Ndërsa sa i përket pagesave të bëra gjatë periudhës nga data 28.02.2018 deri më datë 31.01.2021, gjykata me të drejtë ka aplikuar dispozitën e nenit 293 par.2 të LMD-së si dhe dispozitën e nenit 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkalles se Dytë, po ashtu vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: *”Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve*

komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbarrim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 21 dhe 29 par.1 pika 2 dhe 3 te LPP -së.

Andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me gjendjen faktike rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH. II.nr. 971/23, me datë 09.10.2023

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**